

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORAT

Nr. 91 Prot.

Gjirokastrë, më 18.01.2024

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ në Universitetin e Salentos, Itali

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Salentos hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndër-Institucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me **2 pozicione** për studentë të Departamentit të Gjuhëve të huaja, cikli i parë i studimit (Bachelor), viti i dytë dhe i tretë, të cilët do të angazhohen në mësimnxënie në Universitetin e Salentos. Aktiviteti mësimor do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2024-2025**, semestri i parë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht ose italisht.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **29.01.2024**:

- vërtetim studenti;
- listë notash;
- letër interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV, në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze të nivelit B1;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UOGJ-së dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet Universitetit të Salentos për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash MEMO

REKTOR

